

Kapitulli i Tretë

Mbikëqyrja Bankare

Përmbajtja

1. OBJEKTIVAT STRATEGJIKË TË MBIKËQYRJES BANKARE.	58
2. LICENCIMI DHE RREGULLAT E MBIKËQYRJES	60
2.1 LICENCIMI.	60
3. MBIKËQYRJA E SISTUATËS FINANCIARE TË BANKAVE TË NIVELIT TË DYTË.	62
4. INSPEKTIMI NË VEND.	65
4.1 RAPORTI STANDARD I EKZAMINIMIT TË BANKËS.	66

1. OBJEKTIVAT STRATEGJIKË TË MBIKËQYRJES BANKARE.

Objektivi strategjik i mbikëqyrjes bankare është krijimi i një sistemi bankar të sigurt dhe të shëndoshë.

Në funksion të këtij objekti, Banka e Shqipërisë është e angazhuar që në periudhë afatmesme të sigurojë:

- Krijimin e një kuadri ligjor dhe rregullator që të përafrohet me direktivat e Bashkimit Europian dhe standardet ndërkombëtare të Komitetit të Baselit për mbikëqyrjen bankare.
- Respektimin e kuadrit ligjor dhe rregullator.
- Kufizimin e ndërmarrjes nga ana e bankave, të rreziqeve të tepërta, të cilat, nga ana e tyre, rrezikojnë depozituesit.
- Shtimin e bashkëpunimit me autoritetet mbikëqyrëse të vendeve të tjera, kryesisht të vendeve që kanë investuar në Shqipëri në fushën bankare.

Ndër detyrat specifike që kërkohet të realizohen për periudhën afatshkurtër renditen:

- ⊕ Përmirësimi i mbikëqyrjes në drejtim të lejimit të hyrjes së bankave të reja në vend. Banka e Shqipërisë synon të lejojë hyrjen në treg të bankave dhe të subjekteve të tjera financiare, të cilat premtojnë të krijojnë institucione të shëndosha bankare dhe nuk çenojnë sigurinë dhe qëndrueshmërinë e sistemit bankar. Për këtë synohet:
- ⊕ Rritja e kapitalit minimal për bankat e reja në 7 milionë dollarë amerikanë, sa ai i kërkuar në direktivat e Bashkimit Europian.
- ⊕ Hartimi i kuadrit licencues e rregullativ për subjekte të tjera financiare jobankare për të shtuar llojshmërinë "e lojtarëve" në tregun financiar.
- ⊕ Zgjerimi i kuadrit rregullativ e licencues për të trajtuar edhe çështje të zgjerimit e të reduktimit të aktiviteteve bankare, të bashkimit, të shkrirjes, të ndarjes dhe të thithjes së bankave si dhe të ndryshimit të kontrollit e drejtimit të bankës, fenomene këto të panjohura më parë për sistemin bankar shqiptar.
- ⊕ Përmirësimi i kuadrit rregullator dhe i mbikëqyrjes së bankave të nivelit të dytë. Theksi kryesor në këtë proces do t'i vihet forcimit të zbatimit të rregullave të miratuara; mbajtjes së një pozite më konservatore në normat dhe kërkesat e mbikëqyrjes në raport me standardet ndërkombëtare si pasojë e rrezikut të lartë që paraqet mjedisi ekonomik shqiptar; forcimit të zbatimit të masave korrektuese mbi bankat e nivelit të dytë; forcimit të kapacitetit të inspektimeve në vend dhe reduktimit të kohës midis dy inspektimeve në një bankë tregtare nga 18 në 12 muaj.
- ⊕ Forcimi i aftësive për analizën e situatës financiare të bankave për të zhvilluar sistemin e sinjalizimit të hershëm.
- ⊕ Përmirësimi i mbikëqyrjes së procesit të trajtimit të bankave me probleme.

Gjatë viteve '90, struktura e sistemit bankar shqiptar ka ndryshuar në favor të rritjes së numrit të bankave, në përgjithësi, dhe të rritjes së bankave private me kapital të huaj. Nga tre banka tregtare me kapital shtetëror që u trashëguan, në fund të vitit 1999 sistemi bankar shqiptar përbëhet nga 13 banka të nivelit të dytë. Në këtë vit filluan aktivitetin tre banka të reja private.

Shtirja e kufizuar gjeografike ka qenë një tjetër tipar karakterizues për sistemin bankar gjatë viteve '90. Rrjeti bankar është i përqendruar në qytetin e Tiranës. Gjatë vitit 1997 rrjeti bankar pësoi një reduktim të ndjeshëm, si pasojë e revokimit të licencës për Bankën Tregtare Agrare dhe e uljes së numrit të degëve për

Bankën Kombëtare Tregtare (të dyja banka shtetërore). Gjatë viteve 1998-1999 rrjeti bankar po zgjerohet disi ngadalë nga çelja e degëve dhe e agjencive, tashmë, prej bankave private. Vetëm në vitin 1999 janë hapur 4 degë banke dhe 3 agjenci.

Numri gjithsej i të punësuarve në sistemin bankar, në fund të vitit 1999, arriti në 2813 vetë.

Megjithatë, sistemi bankar vazhdon të jetë i përqendruar dhe peshën kryesore e ka Banka e Kursimeve në mjaft aktivitete bankare. Është vërejtur një tendencë e pastër që kjo bankë të humbasë kuotat e saj në treg, gjë që favorizon konkurrencën, por ky proces po realizohet me ngadalësi. Në këtë mënyrë, tregu bankar shqiptar paraqitet ende me mjaft probleme.

2. LICENCIIMI DHE RREGULLAT E MBIKËQYRJES

Miratimi i ligjit "Për bankat në Republikën e Shqipërisë" në korrik 1998, diktoi rishikimin e krejt kuadrit rregullator të mbikëqyrjes bankare për të siguruar respektimin e klauzolave të ligjit të ri. Në riformulimin e rregullave të mbikëqyrjes iu kushtua kujdes edhe përmbushjes së 25 parimeve bazë të Komitetit të Bazelit për Çështje të Mbikëqyrjes Bankare. Po kështu, më 1 janar 1999 u implementua manuali standard i kontabilitetit për të gjitha bankat. Kjo kërkonte që edhe rregulloret e mbikëqyrjes bankare, sidomos ato që përmbanin llogaritje të treguesve të ndryshëm, të harmonizoheshin me planin e ri të llogarive.

Gjatë vitit 1999 u rishikuan ose formuluan si të reja rreth 13 rregullore. Aktualisht, kuadri rregullator në fushën e mbikëqyrjes bankare konsiderohet pothuajse i plotësuar dhe përgjithësisht në përputhje me standardet ndërkombëtare përkatëse.

2.1 Licencimi.

Në vitin 1999 Banka e Shqipërisë licencoi:

- ◆ tre banka të reja private të quajtura¹:
 - Banka FEFAD;
 - Banka e Parë e Investimeve, Dega Tiranë; dhe
 - Banka Ndërtregtare;
- ◆ një subjekt financiar jobankar², "Unioni Financiar"; dhe
- ◆ dhjetë zyra të këmbimeve valutore³.

Në bazë të ligjit "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", Banka e Shqipërisë lejohet të shtrijë autoritetin e vet mbikëqyrës edhe në subjekte jobankare që ushtrojnë aktivitet financiar. Për këtë arsye, kuadri i rregullave të licencimit u plotësua më tej me miratimin e rregullores "Për dhënien e licencës për të ushtruar veprimtari financiare nga subjekte jobanka në Republikën e Shqipërisë". Kjo rrit sigurinë e sistemit financiar në vend, sidomos pas tronditjes që pësoi ai në krizën e vitit 1997.

¹ Licencimi bëhet në bazë të rregullores për licencimin e bankave.

² Licencimi bëhet në bazë të rregullores për licencimin e subjekteve financiare jobankare.

³ Licencimi bëhet në bazë të rregullores për veprimtarinë valutore.

Box. 15: Rregulloret e miratuara dhe të rishikuara nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë gjatë vitit 1999.

Rregullorja "Mbi madhësinë dhe plotësimin e kapitalit fillestar minimal për veprimtari të lejuara për bankat dhe degët e bankave të huaja". Kjo rregullore përcakton kushtet kur lejohet zgjerimi i aktivitetit të një banke.

Rregullorja "Mbi kërkesat që duhet të plotësojnë administratorët e bankave dhe degëve të bankave të huaja". Në variantin e ri përcaktohen në mënyrë më të plotë kushtet që duhet të plotësohen nga administratorët e bankave, që ushtrojnë veprimtari bankare në Republikën e Shqipërisë.

Udhëzimi "Mbi kapitalin rregullator të bankës", i cili përcakton mënyrën e llogaritjes së këtij treguesi me qëllim mbulimin e rrezikut të kredisë.

Rregullorja "Mbi pozicionin e hapur në valutë" dhe udhëzimi metodik "Mbi rreziqet nga këmbimet valutore". Të dyja këto dokumente synojnë t'u japin bankave një grup rregullash, që i ndihmojnë ato në reduktimin e rrezikut nga veprimtaria valutore.

Rregullorja "Mbi mjaftueshmërinë e kapitalit", e cila përcakton një normë më konservatore për mjaftueshmërinë e kapitalit, duke e rritur nga 8 në 12 për qind.

Rregullorja "Mbi veprimtarinë valutore" qartëson veprimet e lejueshme dhe jo të lejueshme në llogarinë kapitale dhe llogarinë korente. Në këtë rregullore vendosen kriteret mbi bazën e të cilave do të kryhen operacionet e transferimeve të parave nga dhe për në Republikën e Shqipërisë si dhe përcaktohen shumat në valutë, që lejohet të hyjnë dhe të dalin në territorin e saj. Rregullorja i kategorizon pagesat në tregtare dhe jotregtare dhe përshkruan dokumentacionin që nevojitet për kryerjen e këtyre pagesave.

Rregullorja "Mbi risqet e tregut", është një rregullore e re e prezantuar për herë të parë dhe përshkruan kriteret mbi bazën e të cilave do të përcaktohet niveli i mjaftueshëm i kapitalit rregullator për mbulimin e risqeve të tregut.

Rregullorja "Mbi risqet e mëdha", e cila përshkruan kriteret mbi bazën e të cilave do të kontrollohen risqet e mëdha që ndërmerr një bankë si rezultat i përqendrimit të portofolit të saj tek një klient ose një grup i lidhur klientësh.

Udhëzimi "Mbi kontrollin e brendshëm në banka" jep instruksione për bankat tregtare, për të organizuar një sistem më efektiv të kontrollit të brendshëm të tyre dhe për mënyrën se si gjetjet e këtyre kontrolleve raportohen në Bankën e Shqipërisë.

Rregullorja "Mbi pjesëmarrjen në kapitalin e shoqërive tregtare nga bankat dhe degët e bankave të huaja". Në rast se bankat apo degët e bankave të huaja kërkojnë të kenë pjesëmarrje në kapitalin e shoqërive tregtare, më parë ato duhet të sigurojnë autorizimin përkatës nga Banka e Shqipërisë. Për këtë arsye, kjo rregullore kategorizon kushtet kur mund të përfitohet një autorizim i tillë dhe kriteret që duhet të plotësohen nga secili subjekt kërkues.

Rregullorja "Mbi raportin e likuiditetit të bankave", përcakton nivelet sasiore mbi bazën e të cilave bankat do të kufizonin ndërmarrjen e rreziqeve të likuiditetit. Gjatë zbatimit të saj u vërejt se përcaktimi i një niveli sasior nuk ishte një mjet efikas për kontrollin dhe për administrimin e rrezikut të likuiditetit pasi vendoste një normë unike për banka me profile të ndryshme likuiditeti. Prandaj, rregullorja u rishikua, në janar të vitit 2000, duke përcaktuar parimet mbi bazën e të cilave secila bankë administron rrezikun e likuiditetit.

3. MBIKËQYRJA E SITUATËS FINANCIARE TË BANKAVE TË NIVELIT TË DYTË.

Një nga përgjegjësitë e mbikëqyrjes bankare është analizimi i situatës financiare të sistemit bankar dhe të bankave individuale për periudha të rregullta kohore prej tre muajsh.

Në fund të vitit 1999, sistemi bankar shqiptar përmirësoi situatën financiare. Fitimi i rezultuar ishte 1.3 miliardë lekë, ndërkohë që në dy vitet paraardhëse sistemi bankar kishte pësuar humbje të konsiderueshme prej 7.9 miliardë lekë dhe 3.2 miliardë lekë përkatësisht për vitet 1997 dhe 1998.

Nisur nga struktura e sistemit bankar shqiptar vlerësohet se arsyeja kryesore në arritjen e fitimit është klima e favorshme e krijuar për bankat me uljen e vazhdueshme të normës së interesit të depozitave në lekë. Reduktimi i kësaj norme ka ulur koston e fondeve (pasiveve në lekë⁴) të bankave. Nga ana tjetër, *yield*-i bonove të thesarit dhe norma e interesit për huatë janë reduktuar, ndonëse në një kohë të mëvonshme. Kjo ka krijuar më pak presion mbi bankat dhe ka rritur hapësirat për të siguruar fitime. Kështu, të ardhurat neto nga interesat për sistemin bankar kanë rezultuar pozitive për 5.1 miliardë lekë në fund të vitit 1999, nga negative për 39.3 milionë lekë që ishin në fund të vitit 1998.

Sigurimi i fitimit për vitin 1999 ka përmirësuar dhe nivelin e mjaftueshmërisë së kapitalit për sistemin bankar. **Në tërësi, sistemi bankar shqiptar paraqitet jo me kapital të mjaftueshëm si pasojë e mungesës së kapitalit në grupin e bankave shtetërore. Norma e mjaftueshmërisë së kapitalit për sistemin është në masën 8.2 për qind**, nën normën e mbikëqyrjes. Fitimi prej 973 milionë lekësh i bankave shtetërore është një ndër burimet që do të përmirësojë bazën kapitale. Konkretisht, pamjaftueshmëria e kapitalit në këto banka është reduktuar nga rreth -40 për qind në fund të vitit 1998 në -11 për qind në fund të vitit 1999. Megjithatë, norma e mjaftueshmërisë së kapitalit për grupin e bankave me kapital të përbashkët dhe të bankave private (përkatësisht 44.9 dhe 43.5 për qind) është mjaft më e lartë se norma minimale e miratuar (12 për qind). Ky është fakt i rëndësishëm që i krijon hapësira këtyre bankave për të zgjeruar aktivitetin e tyre në të ardhmen pa e cënuar pozicionin e kapitalit.

Pozicioni i kapitalit u forcua edhe si pasojë e vendimit të marrë, në 31 mars 1998 nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, për rritjen e kapitalit minimal të paguar për bankat ekzistuese në 500 milionë lekë brenda muajit shtator 1999. Pothuaj të gjitha bankat e rritën kapitalin e tyre brenda afatit të përcaktuar. Vetëm tri banka nuk respektuan dot afatin. Nisur nga kushtet dhe shkaqet e

⁴ Pasivet në lekë përfaqësojnë 69.5 për qind të totalit të bilancit të sistemit bankar. Përqendrimi i tyre është i ndryshëm për grupe të ndryshme bankash. Konkretisht, bankat shtetërore 81.9 për qind të pasiveve gjithsej e kanë në lekë, ndërsa bankat e përbashkëta dhe ato private e kanë këtë tregues përkatësisht 8.4 dhe 18.8 për qind.

mosrespektimit të afatit, Banka e Shqipërisë miratoi shtyrjen e tij për një bankë deri në shkurt 2000⁵ dhe për dy bankat e tjera deri në fund të vitit 2000.

Megjithëse aktiviteti kredidhënës si sistem bankar, mund të themi që është tepër i papërfillshëm në krahasim me totalin e bilancit, duke zënë vetëm 4,2 për qind të tij, ka rëndësi të trajtohet cilësia e portofolit të huave.

Problemet më të ndjeshme në cilësinë e portofolit të huave u shfaqën gjatë viteve '90 duke detyruar Bankën e Shqipërisë të marrë masa deri në ndërprerjen e kredidhënies në dy bankat me kapital shtetëror dhe në një bankë private. Viti 1999, si rezultat i shtrirjes në këtë aktivitet të shumë bankave private, çoi disi edhe në përmirësimin e situatës në portofolin e kredisë. Kështu, ndërsa si sistem bankar, rreth 39,7 për qind e kredive janë kredi standarde e kundërta ndodh me bankat me kapital shtetëror, ku rreth 87.9 për qind e kredive klasifikohen si kredi me probleme. Megjithatë, një klasifikim i tillë i portofolit, duke qenë se është një problem i trashëguar në vite nuk ka ndikuar ndjeshëm në rëndimin e shpenzimeve financiare për krijimin e fondeve rezervë për mbulimin e humbjeve nga kreditë. Këto shpenzime përfaqësojnë vetëm 4 për qind të totalit të shpenzimeve financiare për sistemin bankar.

Gjatë vitit 1999 struktura e sistemit bankar nuk pësoi ndryshime të ndjeshme. Sistemi bankar shqiptar mbetet një sistem i monopolizuar nga Banka Kursimeve si edhe me një segmentim të aktiviteteve. Bankat shtetërore janë të përqendruara në veprimtarinë në lekë, ndërsa bankat private në valutë. Në përgjithësi, sistemi bankar nuk paraqitet agresiv në procesin huadhënës. Totali i huave gjatë një viti u rrit vetëm 14 për qind ndërkohë që totali i llogarive rrjedhëse dhe depozitave është rritur me 23 për qind.

Tabela 10: Pesha e grupeve bankare sipas disa treguesve ndaj totalit të sistemit bankar (në përqindje).

Treguesi	Grupi 1	Grupi 2	Grupi 3
1. Llogaritë rrjedhëse dhe depozitat	84.8	4.5	10.6
2. Kapitali aksioner	6.6	38.1	55.3
3. Kredia neto	20.0	41.8	38.1
4. Bono thesari	96.0	0.7	3.3
5. Vendorsjet në banka	56.2	11.7	32.2
Burimi: Banka e Shqipërisë			

⁵ Edhe kjo bankë e rriti kapitalin e paguar brenda muajit shkurt 2000.

Tabela 11: Tregues të rentabilitetit në përqindje (viti 1999)

Treguesi	Grupi 1	Grupi 2	Grupi 3	Sistemi bankar
1. Fitimi / PBB-së	0.19	0.04	0.02	0.24
2. ROA ⁶	0.5	1.6	0.3	1.00
3. ROE ⁷		6.1	2.0	27.90
4. Të ardhurat neto nga interesat / aktiveve mesatare gjithsej	2.1	4.1	2.9	2.3
5. Shpenzime të veprimtarisë / aktiveve mesatare gjithsej	0.9	3.0	4.0	1.4
6. Shpenzime për provigjone / aktiveve mesatare gjithsej	0.8	0.6	0.1	0.7

Burimi: Banka e Shqipërisë

⁶ Kthyeshmëria nga aktivet gjithsej.

⁷ Kthyeshmëria nga fondet e veta.

4. INSPEKTIMI NË VEND.

Inspektimet në vend realizohen prej Sektorit të Inspektimeve në Vend në përbërje të Departamentit të Mbikëqyrjes. Gjatë vitit 1999 inspektimet u kryen prej 14 inspektorëve bankarë, të cilët janë përgjegjës për inspektimin e 13 bankave të nivelit të dytë dhe 15 zyrave të këmbimeve valutore. Gjithsej u kryen:

- ◆ 22 inspektime të plota, prej të cilave:
 - 7 në bankat e nivelit të dytë; dhe
 - 15 në zyrat e këmbimit valutor;
- ◆ 18 inspektime të pjeshme në bankat e nivelit të dytë.

Mbikëqyrja bankare dhe inspektimi i bankës, në bazë të ligjeve dhe të rregullave në fuqi, ushtrohet pa dallim në të gjitha bankat, pavarësisht nga origjina e kapitalit të tyre (të huaja apo vendase, shtetërore apo private) dhe pavarësisht nëse janë banka apo degë bankash të huaja.

Ekzaminimi i veprimtarisë bankare, gjatë vitit 1999, është përqendruar edhe në vlerësimin e objektivave strategjike të përcaktuar nga vetë bankat dhe degët e bankave të huaja për zhvillimin e tyre, në biznesplanet si dhe në plotësimin e përmirësimit të politikave dhe të procedurave të brendshme të veprimtarisë, të miratuara nga këshillat drejtuese. Njohja, matja, kontrolli dhe monitorimi i risqeve me të cilat ndeshen bankat e sidomos i risqeve të veprimtarive më të rëndësishme të tyre ka qenë një ndër fushat kryesore të inspektimeve në vend. Kujdes i është kushtuar forcimit të rolit të kontrollit të brendshëm, familiarizimit të personelit të bankave me aktet e brendshme të tyre dhe të autoritetit mbikëqyrës, plotësimin, krahas rritjes së aktivitetit të bankave, me strukturat e nevojshme etj..

Periodha e inspektimit të plotë për çdo bankë, si rregull i përgjithshëm, është caktuar koha prej 18 muajsh. Megjithatë, inspektimet në vend kryhen duke u nisur dhe nga shkalla e rrezikut dhe gjendja financiare e një banke të caktuar me qëllim që të merren në kohë masat e nevojshme korrektuese.

Box. 16: Veprimtaritë e inspektuara.

Gjatë vitit 1999, inspektimet në vend janë përqendruar kryesisht:

Në veprimtaritë bankare që paraqesin rrezik të lartë në aktivitetin e huadhënies.

Janë evidentuar disa probleme kryesore në lidhje me aktivitetin huadhënës. Disa banka jo gjithmonë kanë pasur politika dhe procedura të mjaftueshme për fushat e huadhënies. Ka raste që nuk janë mbajtur parasysht rregulloret dhe udhëzimet e Bankës së Shqipërisë për klasifikimin e kredive dhe krijimin e fondeve rezervë për mbulimin e humbjeve nga huatë. Janë vërejtur shkelje të normave të mbikëqyrjes për një huamarrës ose për grup huamarrësish të lidhur etj.. Fondet rezervë të krijuara nga sistemi bankar për mbulimin e humbjeve nga huatë ishin rreth 12.8 miliardë lekë. Nga inspektimet rezultoi që ky fond duhej të shtohej edhe me 409 milionë lekë të tjera ose me 3.2 për qind.

Në funksionimin e komitetit të administrimit të aktiveve dhe pasiveve (ALCO).

Është vërejtur që në disa banka nuk ka funksionuar ose nuk ka patur procedura të funksionimit të komitetit të administrimit të aktiveve dhe pasiveve (ALCO), si pjesë e rëndësishme të administrimit të bankës.

Në veprimtarinë në monedha të huaja.

Kryesisht janë vërejtur mangësi në lidhje me pasjen e procedurave të mjaftueshme për veprimtarinë valutore të bankës dhe ndjekjen e pozicionit të hapur valutore në përputhje me rregullat e miratuara nga Banka e Shqipërisë.

Në zbatimin e rregullores për veprimtarinë valutore.

Rregullorja "Mbi veprimtarinë valutore" rregullon mënyrën e kryerjes së pagesave korente me jashtë si dhe imponon disa kufizime në llogarinë kapitale. Nga inspektimet në vend rezultoi se disa banka nuk kishin marrë masa të plota për zbatimin e rregullores për veprimtarinë valutore.

Në funksionimin e kontrollit të brendshëm.

Kontrolli i brendshëm, në disa banka, shfaq akoma mangësi që kanë të bëjnë me mosplotësimin me personel të strukturave të miratuara, mungesën e personelit në numër të mjaftueshëm për mbulimin e të gjitha operacioneve të bankës, me moskontrollin me rigorozitet të të gjitha veprimtarive si edhe në disa raste mosrespektimin e linjës së raportimit (këshill drejtues) që cënon pavarësinë e kontrollit.

4.1 Raporti standard i ekzaminimit të bankës.

Një zhvillim i rëndësishëm në procesin e inspektimit në vend të bankave konsiderohet hartimi dhe përdorimi i raportit standard të ekzaminimit. Raporti i ekzaminimit është komunikimi i shkruar, që përdoret për t'u prezantuar tek drejtuesit e Bankës së Shqipërisë dhe tek këshilli drejtues i bankës së inspektuar. Ai përmban gjetjet më të rëndësishme, konkluzionet, dhe rekomandimet për veprime korrektuese, që dalin nga një inspektim në vend të renditura sipas parimit që informacioni rrjedh nga e përgjithshmja tek e veçanta.

Përgatitja e inspektimeve të plota mbi bazën e këtij raporti ka përmirësuar komunikimin me bankat. Drejtuesit e bankës, tashmë mund të gjykojnë më shpejt dhe më mirë se si shkojnë punët në bankë, duke u përqendruar në çështjet dhe problemet kryesore, pa hyrë në detaje që kërkojnë kohë. Raporti i standardizuar ka lehtësuar dukshëm punën ekzaminuese si edhe ka rritur cilësinë e saj.